



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nr. _____ Prot.,

Tiranë, më ____ . ____ . 2025

BISEDIME PËRFUNDIMTARE

*“Në lidhje me çështjen Nr. (JR) 25/2024, që i përket subjektit të rivlerësimit
znj. Ardiana Bera”*

Kërkues/Apelues: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga Drejtuesi i Prokurorisë **z. Altin Dumani**, si dhe nga prokurori **z. Adnan Xholi** (me autorizim)

Objekti: Bisedimet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në seancë gjyqësore, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit me Nr. 760, datë 26.4.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, **znj. Ardiana Bera**

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 dhe 8 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Data e seancës: 5.5.2025

Përpara: GJYKATËS KUSHTETUESE

KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

TIRANË

E nderuar znj. kryesuese e Trupit Gjykses

Të nderuar gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit!

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqsor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u administruan, shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqsor shkaqet e ankimit, prapësimet dhe aktet e administruara në cilësinë e provës në funksion të shkaqeve të ankimit, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke iu qëndruar shkaqeve të ankimit të datës 14.6.2024 dhe parashtrimeve të datës 9.4.2025, në mënyrë të përmbledhur, vlerëson se:

I. LIDHUR ME VLERËSIMIN E KRITERIT TË PASURISË

1. Lidhur me shkakun e ankimit, për pasurinë “*Apartament me sipërfaqe totale 136,7 m²”, ndodhur në rrugën “**** **”, Tiranë*”, vlerësojmë se, edhe në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqsor, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën për sa kemi trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 14.6.2024, si dhe në parashtrimet e datës 9.4.2025, lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie.

1.1 Konkretisht, sa i takon mbulimit me burime të ligjshme të huas në shumën 2.000.000 lekë, deklaruar dhënë hua nga vëllezërit, subjekti i rivlerësimit në seancën gjyqsore të datës 9.4.2025, ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikurse gjatë hetimit administrativ në Komision dhe ka kërkuar të depozitojë në cilësinë e provës akte shtesë lidhur me të ardhurat e vëllait të saj, z. **** **, rezident në Mbretërinë e Bashkuar.

1.1.1 Trupi gjykses i Kolegjit me vendim të ndërmjetëm, ndër të tjera vendosi: *të mos pranojë si provë dokumentacionin e të ardhurave të vëllait të subjektit të rivlerësimit në Angli, pasi nuk është në formën e kërkuar nga ligji.*

1.1.2 Me shkresën Nr. ***/** Prot., datë **.4.2025, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, ka përcjellë në adresë të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, shkresën me Nr. **/** regj., datë **.4.2025, të gjyqtarit kryesues të trupit gjykses të çështjes (JR) nr. 25/2024, datë 3.7.2024, bashkëlidhur së cilës është përcjellë kërkesa e subjektit të rivlerësimit znj.Ardiana Bera, për riçeljen e shqyrtimit gjyqsor dhe administrimin e provave të reja shkresore.

1.1.3 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme konstaton se, bashkëlidhur kërkesës për riçelje të hetimit gjyqsor datë 29.4.2025, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dhe aktet si vijon:

1.1.3.1 Deklaratë noteriale e datës ** prill 2025, me nr. *Protocol Reference: NP**-***, para noterit publik *** ** nga shtetasi *** **, ku ndër të tjera deklaron se [...] *jam rezident për taksa dhe kontribute të të ardhurave në Mbretërinë e Bashkuar prej vitit 1996 [...]*. Bashkëlidhur kësaj deklarate janë depozituar dokumente të apostiluara si vijon:

- Dokumenti i lëshuar nga *Inland Revenue, P***, me *PAYE reference LP***, ***/***, datë **.12.1996, në gjuhën anglisht. Referuar këtij akti konstatohet se në rubrikën “4. *Leaving date*” referohet data **.12.1996, ndërsa në rubrikën “7. *Total pay in this employment*” referohet shuma 1,084.50 GBP¹.

- Informacion i nxjerrë elektronikisht në datë ** prill 2025, nga *** Accounting Ltd., duke vepruar në emër të z. *** **, me numër unik tatimpaguesi **, nga ku konstatohet se për vitin tatimor të përzgjedhur 1999/2000 deklarata është pranuar në ** shtator 2003, por nuk referohet vlera e të ardhurave të realizuara në këtë periudhë tatimore².

- Shkresë e lëshuar nga *** Accounting datë **.4.2025, ku ndër të tjera referohet se kjo shoqëri në cilësinë e kontabilistit të shtetasit *** **, ka kërkuar historikun e plotë të punësimit dhe vetëpunësimit për shtetasin *** ** që nga viti 1996, por sipas njoftimit të marrë nga “*HMRC*” (*HM Revenue and Customs*), përpunimi dhe dërgimi i këtij informacioni kërkon rreth 2-3 muaj.

- Informacion i nxjerrë elektronikisht nga *Regjistri i Sigurimeve Kombëtare* për shtetasin *** **, për periudhën 1995-2025. Ky akt jep të dhëna lidhur me kontributet për shtetasin *** ** për periudhën 1995-2025, por nuk jep të dhëna lidhur me vlerën e të ardhurave të realizuar nga ky shtetas në këto vite³.

1.1.4 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, lidhur me vlerën provuese të akteve bashkëlidhur shkresës me Nr. ***/** Prot., datë **.4.2025 të Kolegjit, për të provuar mbulimin me burime të ligjshme të huas në shumën 2.000.000 lekë, të deklaruar si burim krijimi për pasurinë apartament objekt analize konstaton sa vijon:

1.1.4.1 Aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, provojnë se personi tjetër i lidhur z. *** **, **ka patur qëndrim të ligjshëm në Mbretërinë e Bashkuar së paku nga viti**

¹ Ky akt i është bashkëlidhur edhe vërtetimit noterial të noterës *** **, datë ** prill 2025, me nr. *Protocol reference: NP**-***.

² Ky akt i është bashkëlidhur edhe vërtetimit noterial të noterës *** **, datë ** prill 2025, me nr. *Protocol reference: NP**-***. Konstatohet që informacioni është në gjuhën anglisht dhe i përkthyer në gjuhën shqipe.

³ Ky akt i është bashkëlidhur edhe vërtetimit noterial të noterës *** **, datë ** prill 2025, me nr. *Protocol reference: NP**-***. Konstatohet që informacioni është në gjuhën anglisht dhe i përkthyer në gjuhën shqipe.

1996 e në vijim, që dëshmohet nga *Regjistri i Sigurimeve Kombëtare* dhe nga numri unik i llogarisë së taksave *UTR ****. Referuar aktit *Regjistri i Sigurimeve Kombëtare*, **duket se ky shtetas ka krijuar të ardhura të ligjshme në periudha të ndryshme për të cilat janë paguar kontribute, konkretisht për periudhën 1996-1997** referohet [...] kontribute nga: *Punë e paguar 74.29 GBP [...]*⁴.

1.1.4.2 Gjithashtu rezulton se këto akte të depozituara nga subjekti, **nuk provojnë sa është vlera e të ardhurave të realizuara nga personi tjetër i lidhur, shtetasi *** për periudhën 1995-2005, përveç shumës 1.084,50 GBP**, referuar në aktin e lëshuar nga *Inland Revenue* dhe si rezultat vlerësojmë se edhe me këto prova të reja të paraqitura nuk provohet mundësia financiare e personave të tjerë të lidhur për ti dhënë hua subjektit të rivlerësimit shumën 2.000.000 lekë.

1.1.5 Ky vlerësim, bazohet në jurisprudencën e Kolegjit⁵, i cili për të vlerësuar mbulimin me burime të ligjshme të shumave të cilat i dhurohen ose i jepet hua subjektit prej personave të tjetër të lidhur, vlerëson raportin që krijohet mes të ardhurave të ligjshme dhe shpenzimeve për jetesë të personit tjetër të lidhur për periudhën që analizohet.

1.1.6 Sa më sipër, vlerësojmë se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë vlerën e të ardhurave të realizuar nga personat e tjerë të lidhur përpara dhënies së huasë, përtej shumës prej 1,084.5 GBP, nuk u provua mbulimi me burime të ligjshme i huasë në shumën prej 2.000.000 lekë. Si rezultat nuk u provua mbulimi plotësisht me burime të ligjshme i kursimeve cash të deklaruara në Deklaratën e parë të pasurisë, në shumën 5.000.000 lekë, të cilat, në deklaratat periodike vjetore në vijim deklarohen si burim krijimi për kështet e paguara për blerjen e pasurisë “Apartament me sipërfaqe 136.7 m²”. Sikurse është konstatuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme kursimet cash të deklaruara në Deklaratën e parë të pasurisë, për një diferencë negative në vlerën prej -1.669.152 lekë.

1.2 *Lidhur me pagesën e kështit të fundit, në shumën prej 10.000 USD në vitin 2005*, subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, ndër të tjera, ka deklaruar [...] *detyrimi prej 10.000 USD ka marrë në konsideratë dhe ka njohur dhe pagesën e kryer*

⁴ Referuar aktit *Regjistri i Sigurimeve Kombëtare* konstatohet gjithashtu se për periudhat 1995-1996, 1997-1998, 1998-1999, konfirmohet se viti nuk është i plotë dhe nuk ka një rubrikë për kontributet e paguara. Për periudhën 1999-2000 konfirmohet viti nuk është i plotë, kontribute nga kreditë të sigurimeve kombëtare 40 javë; për periudhën 2000-2001 konfirmohet vit i plotë, kontribute nga kreditë të sigurimeve kombëtare 52 javë; për periudhën 2001-2002 konfirmohet viti nuk është i plotë, kontribute nga kreditë të sigurimeve kombëtare 11 javë.

⁵ Vendimi Nr. 28/2022 (JR), datë 14.07.2022; vendimi Nr. 38/2021 (JR), datë 06.12.2021; Vendim Nr. 26/2021 (JR), datë 04.08.2021.

prej 600.000 lekë, pagesa neto e kryer është diferenca e tyre, ose 435.800 lekë [...]. Në mbështetje të pretendimeve të sipërcituara subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, ndër të tjera, ka paraqitur në cilësinë e provës dhe shkresën e lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., datë **.4.2025. Me anë të kësaj shkrese, shoqëria, ndër të tjera ka informuar subjektin e rivlerësimit se vlera totale e apartamentit është 6.000.000 lekë. Në këtë shkresë citohet se zyra e financës ka arkëtuar shumën e kështit të fundit në nëntor 2005, sipas kontratës së sipërmarrjes (dhe marrëveshjes së palëve) dhe më pas me rikonfirmimin nga ana e inxhinierit të zbatimit për punimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit i ka kthyer subjektit shumën 600.000 lekë.

1.2.1 Kolegji i Posaçëm i Apelimit në seancën gjyqësore të datës 9.4.2025, ndër të tjera ka vendosur, të çelë hetimin gjyqësor të çështjes dhe të pranojë të cilësinë e provës shkresën e lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k. dhe aktet bashkëlidhur.

1.2.2 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, referuar parashtimeve dhe akteve të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, znj. Ardiana Bera, lidhur me pagesën e kështit të fundit të *apartament me sipërfaqe totale 136,7 m²*, vlerëson se edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar nga Komisioni për vitin 2005, në vlerën - 715.068 lekë.

1.2.3 Pretendimi i subjektit të rivlerësimit, për përfshirjen e shumës prej 600.000 lekë, në analizën financiare të vitit 2005, bie ndesh me aktet e administruara në dosje gjatë hetimit administrativ në Komision dhe nuk duhet konsideruar në analizën financiare të vitit 2005, pasi si në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit ashtu edhe në kontratën e shitblerjes, datë 23.9.2011, dhe mandatpagesat e depozituara për këtë pasuri rezulton se shuma e paguar për blerjen e këtij apartamenti është 6.000.000 lekë⁶.

1.2.4 Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, rezulton se, megjithëse subjektit të rivlerësimit i është kaluar barra e provës për pamjaftueshmërinë e konstatuar në vitin 2005, subjekti nuk ka paraqitur akte provuese për të provuar kthimin e pretenduar në shumën 600.000 lekë. Shkresa e depozituar nga subjekti i rivlerësimit rishtas gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, duhet marrë me rezervë pasi vlerësohet si një akt i hartuar për efekt të këtij procesi, dhe me qëllim për të justifikuar pamjaftueshmërinë e të ardhurave për vitin 2005. Gjithashtu, vërejmë se, edhe në konsideratë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit për kthimin e kësaj shume nga

⁶ Në D-Vetting, deklaratat periodike vjetore dhe gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si vlerë për blerjen e apartamentit shumën 6.000.000 lekë. Në kontratën e shitblerjes datë 23.9.2011, çmimi i shitblerjes së pasurisë është 6.000.000 lekë. Vlera totale e mandatpagesave është në shumën 6.000.000 lekë.

shoqëria “****” sh.p.k., në vitin 2005, pretenduar prej saj si i deklaruar edhe në DV-2005 ku subjekti deklaron: [...] *Detyrimi ndaj kontratës së sipërmarrjes për blerjen e apartamentit ... paguar me kursimet nga paga dhe nga kursimet e mbartura minus 600.000 lekë [...]*, përsëri analiza financiare e vitit 2005 do të rezultonte me diferencë negative.

1.3 Duke përfunduar, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme pagesat e kryera për blerjen e pasurisë “*Apartament me sipërfaqe 136,7 m²*”, si dhe kursimet cash të deklaruara si burim krijimi për këto pagesa, duke u ndodhur kështu në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës.

2. *Lidhur me shkakun e ankimit, për pasurinë “automjet tip “Mercedes Benz”, me targë TR *** **” dhe depozitën në shumën prej 9.000 euro, që deklarohet se ka shërbyer si burim krijimi për këtë pasuri, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim dhe nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur me mbulimin me burime të ligjshme të depozitës në shumën prej 9.000 euro, që deklarohet si burim krijimi për pasurinë automjet tip “Mercedes Benz”.*

2.1 Sikurse kemi trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 14.6.2024, si dhe në parashtrimet e datës 9.4.2025, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë⁷ lidhur me burimet e krijimit të pasurisë automjet tip “Mercedes Benz”, me targa TR *** **, dhe nuk ka arritur të provojë të kundërtën sa i takon mbulimit me burime të ligjshme të depozitës në shumën prej 9.000 euro, që deklarohet si burim krijimi për pasurinë automjet tip “Mercedes Benz”, pasi nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, është konstatuar mungesë e burimeve të ligjshme për vitin 2006 në vlerën prej -112.709 lekë. Referuar pretendimeve të subjektit për përfshirjen në analizën financiare të vitit 2006 të likuiditeteve cash në fillim dhe në fund të vitit, si dhe të huas së deklaruar të shlyer në shumën prej 1.000.000 lekë, përsëri rezulton një diferencë negative në vlerën prej - 266.117 lekë. Ky rezultat negativ do të thellohej nëse në analizën financiare do të përfshihej si kursim cash shuma 9.000 euro, që subjekti e ka deklaruar si kursim cash në deklaratën periodike vjetore për vitin 2006, por gjatë hetimit ka deklaruar se këtë shumë nuk e ka disponuar cash, por në llogari bankare.

2.2 Vlerësojmë se rrethanat e mësipërme lidhur me saktësinë dhe mjaftueshmërinë e burimeve të krijimit për pasurinë automjet tip “Mercedes Benz”, me targa TR *** **, blerë në datën *.2.2007, duhen marrë në konsideratë në një vlerësim tërësor të kriterit të

⁷ Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2007 nuk deklarohet burimi i krijimit të automjetit, ndërsa në deklaratën Vetting deklarohet si një nga burimet që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie dhe të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Volkswagen Golf”, që rezulton të jetë shitur disa muaj më vonë.

pasurisë për subjektin e rivlerësimit, znj. Ardiana Bera, duke iu shtuar diferencave negative të trajtuara në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

3. Lidhur me shkakun e ankimit, për llogarinë “****” në lekë, në emër të vajzës së subjektit, në *** Bank, vlerësojmë se edhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar për vitin 2007.

3.1 Sikurse trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 14.6.2024 dhe në parashtrimet e datës 9.4.2025, rezulton se nga analizimi i akteve të administruara në dosje të Komisionit, vlerësojmë se, edhe duke marrë në konsideratë pretendimet e subjektit, se si burim krijimi për këtë llogari bankare kanë shërbyer kursimet cash të disponuara në fillim të vitit, të cilat më pas janë zëvendësuar përsëri me të ardhurat e vitit respektiv, nga analiza financiare vjetore e kryer nga Komisioni, ka rezultuar se pasuritë dhe likuiditetet e krijuara në vitin 2007 nuk mbulohen plotësisht me burime të ligjshme. Sa i takon pamjaftueshmërisë së konstatuar për vitin 2007, vërejmë se llogaritja e shpenzimeve të jetesës për vitin 2007 sipas standardit tashmë të konsoliduar të Kolegjit, e çon pamjaftueshmërinë e vitit 2007 në vlerën prej -716.209 lekë.

3.2 Vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon plotësisht me burime të ligjshme investimet, shpenzimet dhe kursimet e krijuara në vitin 2007, përfshirë këtu dhe krijimin e llogarisë “****” në lekë, në emër të vajzës për një diferencë negative në vlerën -716.209 lekë. Konstatohet po ashtu se, për krijimin e llogarisë në emër të vajzës, në vitin 2007, janë deklaruar si burim shumat e dhëna nga vëllezërit në formë huaje/dhurimi, për të cilat nuk është provuar ligjshmëria e burimit të krijimit.

4. Sa më sipër, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon plotësisht me burime të ligjshme, investimet, shpenzimet dhe kursimet e krijuara për vitet 2003, 2005, 2006 dhe 2007, për një diferencë negative në total rreth 3.200.000 lekë⁸. Edhe në konsideratë të pretendimit të subjektit për kthimin e shumës 600.000 lekë në vitin 2005, sërish diferenca negative e rezultuar nuk justifikon në mënyrë objektive masën e proporcionalitetit të zbatuar deri tani nga Kolegji në raste të ngjashme.

5. Në përfundim, lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, bazuar në aktet e administruara në dosje të Komisionit, si dhe në legjislacionin e zbatueshëm dhe jurisprudencën e Kolegjit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë; (ii) ka

⁸ Referuar analizës financiare të Komisionit, ka rezultuar pamjaftueshmëri në vlerën prej – 1.669.152 lekë për vitin 2003, në vlerën prej – 715.068 lekë për vitin 2005, në vlerën prej – 112.709 lekë për vitin 2006 dhe sikurse është arsyetuar në ankimin e datës 14.6.2024 pamjaftueshmëria e vitit 2007 është në vlerën prej -716.209 lekë.

mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe kryerjen e shpenzimeve ndër vite sikurse trajtuar më sipër në këto parashitja, **duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 3, i lidhur me nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016**

II. LIDHUR ME SHKAKUN ANKIMOR TË VLERËSIMIT TË AFTËSISË PROFESIONALE.

6. Subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtar i trupit gjykues, në gjykimin e procedimit penal në ngarkim të të pandehurit ***. ***, akuzuar për veprën penale “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese” kryer në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave parashikuar nga neni 79 gërma “ë” e Kodit Penal, të pandehurit ***. ***, akuzuar për veprën penale “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese” kryer kundër dy ose më shumë personave parashikuar nga neni 79 gërma “dh” e Kodit Penal me pasojë vdekjen e shtetasve ***. ***, ***, si dhe plagosjen e shtetasve ***. ***, ***, ***, ***, ***, të pandehurit ***.***, akuzuar për veprën penale “Veprime që pengojnë zbulimin e të vërtetës” parashikuar nga neni 301 i Kodit Penal. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin Nr. *** datë **2.2013, ka vendosur **deklarimin e pafajshëm të pandehurit ***. ***, deklarimin e pafajshëm të pandehurit ***. ***, deklarimin e pafajshëm të pandehurit ***. ***,**

7. **Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin Nr. *** datë **9.2013**, pas ankimit të organit të akuzës, ka vendosur **ndryshimin e vendimit Nr. *** datë **2.2013** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të pandehurin ***. ***, deklarimin **fajtor** të tij për kryerjen e veprës penale “Vrasje nga pakujdesia”, me pasojë vdekjen e shtetasit ***. ***, parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal dhe dënimin me 1 (një) vit burgim; për të pandehurin ***. ***, deklarimin **fajtor** të tij për kryerjen e veprës penale “Vrasje nga pakujdesia”, me pasojë vdekjen e shtetasit ***. ***, parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal dhe dënimin me 3 (tre) vjet burgim. Lënien në fuqi të vendimit për pjesën tjetër të tij.

7.1 Në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, konstatohet ndërlidhja me aspektin e njohurive të gjyqtarit në kuptim të procesit të rivlerësimit kalimtar të magjistratëve duke e drejtuar vlerësimin në treguesin e parashikuar në nenin 72 pika 2 e ligjit Nr. 96/2016, “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Konkretisht në pikën 102 të vendimit, Gjykata ka konstatuar dhe arsyetuar se: [...] *I pabazuar në ligj është qëndrimi i Gjykatës së Shkallës së Parë sipas të cilit ajo nuk mund të bënte*

ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës penale. Lidhur me çështjen nëse gjykata mund të bëjë ndryshim të cilësimit juridik të faktit objekt akuze, në vendimin me nr. 50/99 i Gjykatës Kushtetuese thuhet se “E drejta që i lihet gjykatës për ti dhënë faktit një përcaktim juridik të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori, nuk është veprim antikushtetues. Në këtë rast gjykata nuk merr kompetencat e prokurorit dhe as kthehet në organ akuze, por vetëm zbaton ligjin gjë që është detyrë funksionale e asaj

Kuptimi në këtë mënyrë i përmbajtjes së nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale i shërben dhënies së drejtësisë, sepse në të kundërtën ajo do të vepronte në kundërshtim me provat dhe me ligjin. Në rast se gjykata nuk do të bënte një cilësim të drejtë të veprës penale, vendimi i saj do të prishej nga gjykata më e lartë për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit. Pra, edhe në këtë aspekt, gjykata është e detyruar të bëjë vetë ndryshimin e cilësimit të veprës kur ky është i ndryshëm nga ai i prokurorit.... gjykata nuk është organ akuze, nuk formulon akuzë të re dhe as e ndryshon atë, por mbi bazën e faktit të paraqitur, bën cilësimin e duhur ligjor të veprës, duke i dhënë faktit një përcaktim tjetër. Në këtë rast, gjykata bën një interpretim të ligjit që ajo zbaton dhe që është në kompetencë të saj dhe nuk cenon aspak kompetencat e prokurorit [...].

8. Komisioni në aktin “Rezultate të hetimit administrativ”⁹ i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me dy çështje të cilat kanë marrë vëmendjen e opinionit publik duke referuar linkun nga media online, për të cilat subjekti i rivlerësimit dha shpjegime në parashtrimet e datës 19.4.2024¹⁰.

9. Komisioni në vendimin Nr. 760 datë 26.4.2024¹¹ ka arritur në përfundimin se çështja është ende në gjykim në kuptim të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, ndaj dhe nuk mund të shtrihet vlerësimi profesional për subjektin e rivlerësimit lidhur me këtë çështje. Në pjesën arsyetuese të vendimit të Komisionit, vendimet gjyqësore mbi të cilat mbështet këtë përfundim janë, vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me nr. **-***-***(**) i datës **.3.2024 dhe vendimi i Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut i datës ** nëntor 2023.

10. Ashtu sikurse është parashtruar në ankimin e datës 14.06.2024 të Komisionerit Publik, vendimet gjyqësore të referuara sa më lart edhe pse lidhen me të njëjtën ngjarje, kanë të bëjnë me një procedim të pezulluar dhe të ndarë, të ndryshëm nga ai që është objekt i gjyqimit të konkluduar me vendimin Nr. ***, datë **.2.2013 të Gjykatës së

⁹ Referojuni fq. 46, dhe linkut të mëposhtëm:

https://***.com/lajm/kush-eshte-gjyqtaja-ardiana-bera-qe-skandalizoi-nderkombetaret-me-vendimin-per-21-janarin-denoj-me-burg-nenen-qe-8-me-pare-lindi-djalin-psej-2-vitesh-ne-proces-vetingu.

¹⁰ Referojuni fq. 46-48 të aktit “Prapësime parashtrime/prapësime të gjyqtarës Ardiana Bera, mbi gjetjet e njoftuara me raportin e rezultateve të hetimit paraprak”

¹¹ Referojuni fq. 34-35 të vendimit të Komisionit.

Rrethit Gjyqësor Tiranë, **ndaj dhe përfundimi i Komisionit është i pabazuar dhe për këtë çështje do të duhej të mbahej qëndrim.**

11. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në vendimin e datës ** nëntor 2023 “Çështja *** kundër Shqipërisë” (Kërkesa nr. ***/**) ¹², në paragrafin 180 të saj arsyeton se: [...] Si rregull i përgjithshëm, kur janë zhvilluar procese të brendshme, nuk është detyrë e Gjykatës që të zëvendësojë vlerësimin e fakteve prej saj me atë të gjykatave vendase dhe u takon këtyre të fundit të përcaktojnë faktet në bazë të provave përpara tyre ... Megjithëse Gjykata nuk është e detyruar nga gjetjet e gjykatave vendase dhe mbetet e lirë të bëjë vlerësimin e saj në dritën e të gjithë materialit para saj, në rrethana normale ajo kërkon elemente bindëse që ta shtojnë atë të largohet nga gjetjet e faktit të nxjerra nga gjykatat e brendshme [...].

12. Në këtë vendim të Gjykatës Evropiane pasqyrohen si faktet e procedimit penal gjykuar nga gjykatat e vendit ashtu edhe vlerësime të kontekstit të mbrojtjes konventore për nenin 2 “E drejta e jetës”. Paragrafët nga ky vendim të ndërlidhur dhe në kontekstin e vlerësimit të aftësisë profesionale duke respektuar përcaktimin ligjor se nuk gjykohet korrektësia e vendimit dhe themeli i çështjes (neni 72 pika 4 e ligjit nr. 96/2016) janë si në vijim:

12.1 **Lidhur me pasqyrimin e fakteve të kronologjisë së gjykimeve në vend në vendim, ndër të tjera citohet:**

[...] 56. Sipas aktakuzës, më ** janar 2011, mes orës 16:00 dhe 16:10, ***, ***, dhe ***, ***, kishte qëlluar njëkohësisht me plumba të vërtetë drejt protestuesve. Ndryshe nga deklarata e tij fillestare, ku ai nuk kishte përmendur gjuajtjen me armë në ditën e protestës (shihni paragrafin 39 më lart), ***, ***, dyshohet se ka qëlluar njëmbëdhjetë plumba në drejtim të një grupi protestuesish, duke vrarë njërin prej tyre. ***, ***, dyshohet se ka qëndruar pranë atij protestuesi. Pas përfundimit të protestës, dyshohet se ***, ***, ka ndërruar tytën e pistoletës së tij me atë të ***, ***, (shihni paragrafin 46 më lart) – koleg i Gardës dhe i bashkakuzuar në proces – për të fshehur faktin që ***, ***, kishte qëlluar me armën e tij. Mbështetur në ekzaminimin e rrobave të viktimave, nga të cilat nuk u zbuluan mbetje baruti, prokurorët konfirmuan se viktimat nuk kishin përdorur armë zjarri.

57. Për sa i përket ***, ***, ai dyshohet se ka qëlluar me breshëri katër ose pesë të shtëna në ajër përpara se të ulte objektivin dhe të qëllonte drejtpërdrejt një grup protestuesish, njëri prej të cilëve vdiq dhe të tjerët u plagosën.

¹² Referojuni Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë me nr.175, datë 6 dhjetor 2023.

58. Më ** shkurt 2013, Gjykata e Rrethit Tiranë shpalli të pafajshëm ***, ***, dhe ***, ***, (shihni paragrafin 47 më lart). Në lidhje me ***, ***, gjykata pranoi se plumbi i dalë nga pistoletë e tij kishte vrarë një nga protestuesit, i cili kishte vdekur në vend; megjithatë, prokurorët nuk kishin arritur të vërtetonin rrethanat e sakta të këtij veprimi – në veçanti, nëse viktimë kishte qenë brenda fushëpamjes së ***, ***, dhe nëse i akuzuari kishte vepruar me qëllimin e destinuar për të vrarë viktimën. Rrjedhimisht, ***, ***, nuk kishte kryer veprën penale të “vrasjes me dashje e kryer në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave”, sipas nenit 79 § (ë) të Kodit Penal. Po kështu, gjykata konstatoi se provat para saj vërtetonin se protestuesi i dytë kishte vdekur si pasojë e një plumbi rikoshet që ishte qëlluar nga ***, ***,; megjithatë, nuk ishte vërtetuar se i akuzuari kishte vepruar me qëllim të destinuar për të vrarë viktimën. Për sa i përket viktimës së tretë dhe personave që ishin plagosur, gjykata konstatoi se nuk kishte prova që implikonin ***, ***. Rrjedhimisht, ajo arriti në përfundimin se ***, ***, nuk ishte fajtor për veprën penale të “vrasjes me dashje të dy ose më shumë personave”, sipas nenit 79 § (dh) të Kodit Penal. Në fund, gjykata vuri në dukje se prokurorët kishin tërhequr akuzën për pengimin e drejtësisë ndaj ***, ***, i cili fillimisht ishte akuzuar se ishte përfshirë në ndërrimin e tytës së armës së ***, ***, pas ngjarjes së 21 janarit 2011 për qëllim të fshehjes së fakteve në lidhje me ngjarjen (shihni paragrafin 46 më lart). Gjykata e shpalli *** ****, të pafajshëm për atë vepër.

59. Më ** shtator 2013, Gjykata e Apelit Tiranë, me dy vota pro dhe një kundër, shpalli ***, *** dhe ***, ***, fajtor për vrasje nga pakujdesia, sipas nenit 85 të Kodit Penal dhe i dënoi përkatësisht me një dhe tre vjet burg. Gjykata la në fuqi pjesën e mbetur të vendimit të shkallës së parë.

60. Gjykata e apelit, në përgjithësi, ra dakord me gjetjet faktike të bëra nga gjykata e shkallës së parë. Ajo vuri në dukje, në mënyrë të veçantë, se në fillim protesta kishte qenë paqësore, por që më pas ishte bërë e dhunshme dhe protestuesit kishin hedhur sende dhe kishin fyer oficerët e Gardës. Gjithashtu, u shpreh se oficerët e Gardës, pasi kishin paralajmëruar protestuesit, kishin përdorur plumba të vërtetë rreth orës 16:00, kur “rreth 100 protestues kishin hapur me forcë njërin nga portat” e Kryeministrit. Për më tepër, gjykata u shpreh se oficerët e Gardës, përfshirë ***, ***, dhe ***, ***, kishin përdorur armët e tyre të zjarrit pothuajse në të njëjtën kohë për të qëlluar në ajër, duke përdorur plumba të vërtetë, për të penguar turmën e dhunshme. Megjithatë, nuk u vërtetua se ata kishin qëlluar drejtpërdrejt në drejtim të dy viktimave, në trupat e të cilëve ekspertët kishin gjetur plumba të qëlluar nga armët e ***, ***, dhe ***, ***,

62. Megjithatë, gjykata arriti në përfundimin se forca vdekjeprurëse e përdorur nga dy të pandehurit kishte qenë jo proporcionale, pasi dy viktimat nuk kishin kryer asnjë akt dhune në momentin në fjalë. Gjykata vazhdoi të konstatonte se të pandehurit duhet të kishin parashikuar pasojat e mundshme të vendimit të tyre për të qëlluar në ajër duke përdorur plumba të vërtetë. Prandaj, të pandehurit u shpallën fajtorë për vrasje nga pakujdesia sipas nenit 85 të Kodit Penal.

63. **Një gjyqtare pati mendim pakice.** Ajo u shpreh se, sipas saj kishte prova të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se ***, *** dhe ***, *** kishin pasur objektiv të drejtpërdrejtë turmën e protestuesve dhe jo të qëllonin në ajër. Ajo shtoi se, sipas saj të pandehurit nuk kishin një objektiv të veçantë, por megjithatë kishin qenë në gjendje të parashikonin pasojat e mundshme të veprimeve të tyre dhe për këtë arsye kishin vepruar me qëllim indirekt (dolus eventualis) dhe jo me pakujdesi. **Ajo konkludoi se ata duhej të shpallehin fajtorë për vrasje.**

12.2 Lidhur me aspektin material shkelja e nenit 2 “E drejta për jetë” e Konventës, në vendim, ndër të tjera citohet:

[...] 107 ... ”230. Ndalimi i përgjithshëm me ligj i vrasjes arbitrare nga punonjësit e shtetit do të ishte i paefektshëm, në praktikë, nëse nuk do të ekzistonte një procedurë për shqyrtimin e ligjshmërisë së përdorimit të forcës vdekjeprurëse nga autoritetet shtetërore..... Prandaj, shteti duhet të sigurojë, me të gjitha mjetet që ka në dispozicion, një përgjigje të duhur – gjyqësore ose tjetër – në mënyrë që kuadri ligjor dhe administrativ i krijuar për të mbrojtur të drejtën për jetën të zbatohet siç duhet dhe çdo shkelje e kësaj të drejte të goditet dhe të ndëshkohet [...].

117. Së pari, hetimi nuk duket se ka përcaktuar kronologjinë e saktë të: (i.) momentit(eve) kur u qëlluan katër viktimat kryesore (disa prej të cilave u regjistruan nga media dhe kalimtarë të tjerë) ose (ii.) të plagëve jo vdekjeprurëse me armë zjarri të pësuar nga disa persona të tjerë. Ky mund të ishte një element i rëndësishëm në vlerësimin e rrjedhës dhe natyrës së saktë të plagëve të marra nga viktimat e ndryshme dhe se si mund të ishin shkaktuar ato. Gjykata e Apelit konstatoi në lidhje me këtë se disa oficerë të Gardës, pothuajse në të njëjtën kohë, kishin ngritur armët e tyre të zjarrit dhe kishin qëlluar në ajër me plumba të vërtetë për të frenuar turmën e dhunshme (shihni paragrafin 60 më lart).

118. Një grup i dytë pyetjesh lidhet me rrjedhën dhe natyrën e çdo urdhri të dhënë nga komandantët e Gardës në terren, të cilët duket se kanë qenë në një farë mase në komunikim me radio me njëri-tjetrin (shihni paragrafin 37 më lart) në momentet kritike

të konfrontimit të dhunshëm. Punonjësit e Gardës dhe oficerët e lartë të pyetur nga hetuesit dhe gjykatat kombëtare u shprehën se nuk ishte dhënë asnjë urdhër, në asnjë moment, për të qëlluar në ajër ose ndryshe, dhe që secili oficer e kishte marrë vetë atë vendim. Gjykata ka dyshime nëse ky version i ngjarjeve mund të konsiderohet i besueshëm për të treguar një mënyrë veprimi për një forcë të armatosur të centralizuar dhe të specializuar që e gjen veten përballë një turme armiqësore; kjo duket se është gjithashtu në kundërshtim me udhëzimet dhe rregullat e angazhimit që komanda e Gardës ju kishte dhënë njësisë së saj në përgatitje të protestës (shihni paragrafin 8 më lart, shihni gjithashtu paragrafin 167 më poshtë).

119. Së treti, dhe pavarësisht nga natyra e çdo urdhri që mund të jetë dhënë ose jo, kërkueset kanë argumentuar, si në nivel të brendshëm ashtu edhe përpara Gjykatës, se nuk është hetuar siç duhet nëse ndonjë nga punonjësit e Gardës ka qëlluar në drejtim të turmës. Kërkueset pohuan se vrasjet ishin transmetuar në televizion; Gjykata vëren në këtë drejtim se oficerët e pyetur nga autoritetet kombëtare e mohuan me forcë një mundësi të tillë, duke pohuar se ata kishin qëlluar në ajër vetëm për qëllime frenimi të turmës. Gjykata e Apelit Tiranë arriti në përfundimin se dy personat për vdekjen e të cilëve dy oficerët e Gardës ishin shpallur përgjegjës penalisht, me gjasë kishin qenë viktimat rastësore të të shtënave në ajër nga oficerët në fjalë, dhe se ato të shtëna kishin bërë rikoshet në objekte të forta përpara se të goditeshin viktimat.

159. Për sa i përket çështjes nëse përdorimi i forcës vdekjeprurëse ishte legjitim, qeveria e pranoi se nuk ishte legjitim. Gjykata rithekson se përdorimi i forcës vdekjeprurëse mund të justifikohet vetëm për një nga arsyet e renditura në nenin 2 § 2 të Konventës, përkatësisht: a) në mbrojtje të çdo personi nga dhuna e paligjshme; b) për të kryer një arrestim të ligjshëm ose për të parandaluar arratisjen; c) për të kundërshtuar një trazirë ose kryengritje. Thënë kjo, pyetja e parë që duhet të adresohet është nëse përdorimi i armëve të zjarrit kundër demonstruesve, më 21 janar 2011, u bë sipas ndonjë nga tre qëllimeve legjitime të lartpërmendura. Është e qartë se arsyet nën pikën “b” nuk ishin të vlefshme në rastin konkret. Për sa u përket arsyeve nën pikën “a” dhe “c”, Gjykata vëren se rreth orës 14:30 disa nga protestuesit filluan të hedhin sende të forta, përfshirë gurë, kundrejt kordonit të parë të policëve të zakonshëm dhe se disa nga oficerët pësuan lëndime (shihni paragrafët 12 dhe 16 më lart). Megjithatë, përdorimi i armëve të zjarrit nga Garda filloi pak pas orës 16:00, kur një grup më i vogël protestuesish të mbetur hynë në oborrin e Kryeministrit. Mbetet e paqartë se çfarë saktësisht çoi në reagimin e oficerëve që të qëllonin me armët e tyre të zjarrit, sepse protestuesit që depërtuan perimetrin e sigurisë tashmë ishin shtyrë nga një grup

oficerësh të pajisur me mburoja dhe shkopinj gomë (shihni paragrafët 13 dhe 14 më lart). Duke marrë parasysh afatin kohor të këtyre ngjarjeve dhe provat e tjera në dispozicion në dosjen e çështjes, nuk është provuar se në momentin kur u përdorën plumbat e vërtetë, grupi relativisht i vogël i protestuesve të dhunshëm përbënte një rrezik serioz dhe të çastit ndaj ndonjë personi – duke përfshirë vetë oficerët e Gardës ose ndonjë nëpunësi të shtetit që mund të ketë qenë brenda ndërtesës. Në fakt, duket se arsyeja kryesore e paraqitur gjatë procesit gjyqësor kombëtar ishte se armët e zjarrit ishin përdorur në mbrojtje të sigurisë së objektit. Megjithatë, kjo në vetvete nuk mund të konsiderohet se në rrethanat në fjalë përbën shkak legjitim për përdorimin e forcës vdekjeprurëse. Gjithashtu, nuk kishte asnjë tregues se ekzistonte një rrezik real dhe i çastit ndaj personave në ndërtesë apo ndaj ndonjë personi tjetër.

162. Edhe nëse Gjykata pranon që oficerët nuk kanë bërë asgjë më shumë se kanë qëlluar në ajër për paralajmërim, nuk është treguar se kjo është kryer në përputhje me kërkesat e nenit 2. Në lidhje me këtë, Gjykata rithekson se, sipas përkufizimit, të shtënat paralajmëruese duhet të bëhen në ajër, me armën mbajtur pothuajse në drejtim vertikal, në mënyrë që të sigurohet që objektivi të mos qëllohet ... Kjo ishte edhe më thelbësore në rastin konkret, pasi kishte të bënte me një demonstratë ku morën pjesë një numër i madh personash, dhe çdo veprim i pakujdesshëm nga ana e oficerëve të gardës për përdorimin e armëve të zjarrit mund të kishte pasur një rezultat fatal. Rrjedhimisht, është e vështirë të imagjinohet që të shtënat në ajër në një kënd të kujdesshëm mund të kenë goditur në kokë viktimën që qëndronte në nivelin e rrugës, madje edhe si rezultat i një rikosheti [...].

170. Gjykata vëren gjithashtu se paralajmërimi me gojë i bërë përpara përdorimit të armëve të zjarrit nuk përmendte në mënyrë të shprehur që oficerët do të qëllonin, por vetëm se “masa” do të ndërmerreshin “në përputhje me ligjin” (shihni paragrafin 15 më lart). Ky paralajmërim ishte i paqartë dhe i pasaktë, dhe nuk mund të konsiderohej se përbënte një paralajmërim të duhur përpara përdorimit të armëve potencialisht vdekjeprurëse.

171. Duke pasur parasysh vlerësimin e paraqitur më sipër, Gjykata del në përfundimin se përdorimi i forcës vdekjeprurëse nga oficerët e Gardës, që rezultoi në vdekjen e të afërmit ***, ***, të kërkueseve, nuk ishte në përputhje me kërkesat e rrepta të nenit 2 të Konventës. Gjykata ka gjetur mangësi në kuadrin ligjor që rregullon përdorimin e armëve potencialisht vdekjeprurëse në lidhje me operacionet e kontrollit të turmës në përgjithësi, probleme të rënda në planifikimin dhe kontrollin e ngjarjes në shqyrtim dhe dështimin për të treguar se përdorimi i forcës vdekjeprurëse nga oficerët e Gardës që

rezultoi në vdekjen e anëtarit të familjes së kërkueses ishte absolutisht i nevojshëm, duke pasur parasysh rrethanat [...].

13. Sa më sipër, **vlerësojmë se** neni 375 i Kodit të Procedurës Penale, parashikon të drejtën e gjykatës si organ që jep drejtësi, të kualifikojë saktë faktin kriminal për të cilin është ngritur një akuzë, duke e përcaktuar atë ligjërisht saktë sipas vlerësimit të saj dhe analizës që ajo bën në përfundim të gjykimit të një çështjeje penale. Kjo kompetencë e gjykatës nuk mund të barazohet me të drejtën e prokurorit për të ngritur akuzë për një fakt të ri, e cila, në rast se ndodh, duhet t'u nënshtrohet të gjitha rregullave procedurale të cilat garantojnë të drejtat e liritë themelore të palëve në proces, në kuptim të zhvillimit të një procesi të rregullt, sipas parashikimit të nenit 6 të KEDNj-së e nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Vlerësojmë se mangësia në aspektin e njohurive ligjore për zbatimin e nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale, sipas jurisprudencës kushtetuese që daton më 30.07.1999 (vendimi nr. 50, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë), periudhë e hershme që i mundësonte subjektit të rivlerësimit njohjen dhe familjarizimin me të, duket se afekton besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, duke pasur në konsideratë edhe faktin që ngjarja ka qenë publike, tejet sensitive për shkak të rrethanave se si ka ndodhur si edhe ndjeshmërisë së lartë publike për shkak të vëmendjes së shtuar për zbardhjen e së vërtetës. Në këto kushte, diligenca publike drejt këtij procesi ka qenë e lartë. Për pasojë, edhe mangësitë e konstatuara në ushtrimin e funksionit si një nga anëtarët e trupit gjykues me peshë të posaçme ndikuese.

14. Duke përfunduar çmujmë se ndonëse kjo mangësi **nuk rezulton të jetë e mjaftueshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit është i paaftë në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale**, por është e vlefshme për tu konsideruar, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në një vlerësim të përgjithshëm të tri kriterëve të rivlerësimit të këtij procesi, duke thirrur për zbatim aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

III. KËRKIMI PËRFUNDIMTAR

15. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke iu qëndruar shkaqeve të ankimit të datës 14.06.2024 dhe parashtrimeve të datës 09.04.2025, mbështetur në sa më sipër trajtuar, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, pikës 2 të nenit 4, pikës 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit Nr. 760, datë 26.4.2024 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit znj. Ardiana Bera.

DREJTUESI I PROKURORISË

PROKURORI I AUTORIZUAR

Altin DUMANI

Adnan XHOLI